



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1531 Prot.

Tiranë, më 26.12.2017

**VENDIM**

**Nr.240, datë 26.12.2017**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT  
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 64, DATË 30.03.2017,  
NË INSTITUCIONIN E BASHKISË BULQIZË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 64, datë 30.03.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 17, datë 09.02.2017”, në institucionin e Bashkisë Bulqizë,

**KONSTATOVA SE:**

Me Vendimin Nr. 17, datë 09.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.90, datë 25.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Bulqizë, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit në Bashkinë Bulqizë, prej datës 27.04.2016, e në vazhdim. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 64, datë 30.03.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 17, datë 09.02.2017”, të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me 28 (njëzet e tetë) rastet e emërimit në kundërshtim me ligjin të veprojë si më poshtë:

- ✓ Të anulojë aktin nr. 139/1, datë 25.05.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Manaxhimit të Burimeve Njerëzore”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 154, datë 06.07.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Menaxhimit të Pronave në Njësinë Administrative Ostren”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 175, datë 02.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Menaxhimit të Pronave”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 176, datë 02.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Emergjencave Civile”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 50, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Bujqësisë, Mbrojtjes, Administrimit të Tokës, në Njësinë Administrative Trebisht”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 150, datë 11.04.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Bujqësisë, Mbrojtjes, Administrimit të Tokës, në Njësinë Administrative Gjoricë”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 199, datë 21.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Bujqësisë, Mbrojtjes, Administrimit të Tokës, në Njësinë Administrative Zerqan”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 24/1, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Bujqësisë, Mbrojtjes, Administrimit të Tokës, në Njësinë Administrative Shupenzë”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 46, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist veterinarie në Njësinë Administrative Ostren, Trebisht, Martanesh dhe Zerqan”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 196, datë 19.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist veterinarie në Njësinë Administrative Shupenzë”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 95, datë 07.09.2015, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist veterinarie”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 49, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Ndihmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Trebisht”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 44, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Ndihmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Ostren”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 37, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialiste e Ndihmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Gjoricë”.
- ✓ Të anulojë aktin nr. 19, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Ndihmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë”.

- ✓ Të anulohet aktin nr. 79, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Martanesh”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 21, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Zerqan”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 195, datë 19.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialiste e Barazisë Gjimore dhe Dhunës në Familje”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 48, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Trebisht”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 43, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Ostren”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 42, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Gjoricë”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 16, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 81, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Martanesh”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 27, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialiste e Protokoll arkivës, në Njësinë Administrative Martanesh”.
  - ✓ Të anulohet Kontratën e Punës, datë 01.09.2015, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialiste e arkivës, në Bulqizë”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 158, datë 21.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Median”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 17, datë 08.01.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i N.M për menaxhimin e pronave, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë”.
  - ✓ Të anulohet aktin nr. 184, datë 02.09.2016, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Specialist i Kontrollit në Terren”, emëruar në detyrë me aktin.
2. Njësia përgjegjëse të planifikojë veprimtarinë, me qëllim që anulimi i akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke e ndarë në dy faza.

3. *Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2017 planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet në pikat më sipër të këtij vendimi.*
4. *Njësia përgjegjëse, të përmbyllë procesin e nisur për 18 procedurat e konkurrimit, dhe të fillojë procesin për 10 pozicionet e tjera të lira në kuptim të ligjit, duke u kujdesur për përmbushjen e rregullave të përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe duke u bazuar në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.*

*Në veçanti, njësia përgjegjëse në vijim të procesit, duhet të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:*

- ✓ *Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimit dhe vlerësimit (Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës, pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.*
- ✓ *Të bëhen publike në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Bulqizë dhe në stendat e njoftimeve për publikun, aktet si më poshtë:*
  - a. *Akti i shpalljes për plotësim i pozicionit të lirë të punës në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreun III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë*

*apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.*

- b. Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
  - c. Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.*
  - d. Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.*
- 5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Bulqizë të fillojë zbatimin e vendimit brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Nr. 64, datë 30.03.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 17, datë 09.02.2017”, me Vendimin Nr. 176, datë 27.07.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 64, datë 30.03.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 17, datë 09.02.2017’”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 64, datë 30.03.2017.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Ilirjan Osmanlliu dhe Joni Marko, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 20.09.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Bulqizë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Bulqizë dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1531/2 prot., datë 27.07.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit është materializuar në procesverbalin e datës 20.09.2017, të mbajtur nga grupi i punës i

Komisionerit dhe i nënshkruar nga personat e kontaktit të institucionit të Bashkisë Bulqizë.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikat 1 dhe 2 të vendimit, Komisioneri i ka lënë detyrë Kryetarit të Bashkisë, e më tej, njësisë përgjegjëse të institucionit, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me emërimin në kundërshtim me ligjin të 28 punonjësve (\*\*\*\*\*), të anulojë aktet e emërimit, duke e kryer këtë proces në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së lirë të pozicioneve të mbajtura prej tyre dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, në përputhje me nenet 22, 23 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi në subjekt grupi i punës administroi njoftimet për përfundimin e marrëdhënies së punës dhe vendimet e anulimit të akteve të emërimit të dala në kundërshtim me ligjin, për punonjësit si më poshtë:

1. Njoftimi Nr. 2598/2 prot., datë 21.07.2017, “Njoftim për përfundimin e marrëdhënies së punës” për arsye të mospërbushjes së kriterit arsimor dhe Vendimi Nr. 115, datë 21.08.2017, “Për ndërprerjen e marrëdhënies financiare” për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Trebisht”, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Vendimi Nr. 120, datë 06.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist veterinarie”;
3. Vendimi Nr. 121, datë 06.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”;
4. Vendimi Nr. 122, datë 06.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Kontrollit në Terren”;
5. Vendimi Nr. 123, datë 06.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Bujqësisë, Mbrojtjes, Administrimit të Tokës, në Njësinë Administrative Shupenzë”;
6. Vendimi Nr. 124, datë 06.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Ndhmës Ekonomike, në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë”;



7. Vendimi Nr. 125, datë 06.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Bujqësisë, Mbrojtjes, Administrimit të Tokës, në Njësinë Administrative Trebisht”;
8. Vendimi Nr. 126, datë 06.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist veterinarie në Njësinë Administrative Shupenzë” “Specialist veterinarie”;
9. Vendimi Nr. 127, datë 06.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist veterinarie në Njësinë Administrative Ostren, Trebisht, Martanesh dhe Zerqan” “Specialist veterinarie”;
10. Vendimi Nr. 139, 18.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialiste Protokoll Arkivës, në Njësinë Administrative Martanesh”;
11. Vendimi Nr. 140, datë 18.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Protokoll Arkivës, në Njësinë Administrative Gjoricë”;
12. Vendimi Nr. 141, datë 18.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialiste e arkivës në Bulqizë”;
13. Vendimi Nr. 142, datë 18.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialiste e Protokoll Arkivës në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë”;
14. Vendimi Nr. 143, datë 18.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Protokoll Arkivës, në Njësinë Administrative Ostren”;
15. Vendimi Nr. 144, datë 18.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Protokoll Arkivës, në Njësinë Administrative Trebisht”;
16. Vendimi Nr. 145, datë 18.09.2017, “Për revokimin e aktit të emërimit”, për punonjësin \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Median”;
17. Me shkresën nr. 2776 prot., datë 17.07.2017, “Njoftim për përfundimin e marrëdhënies së punës”, punonjësja \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialiste e Protokoll Arkivës në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë” është njoftuar se për shkak të mospërbushjes së kriterit arsimor do t’i shkëputet marrëdhënia e punës brenda 3 muajve, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
18. Me aktin nr. 34/1, datë 19.01.2016, “Akti i Deklarimit të Statusit të Punësimit”, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Bulqizë, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësës \*\*\*\*\*, nga ku rezultoi se ajo ishte emëruar më datë 01.08.1999, në detyrën “Specialiste Arkiv-Protokollit” në ish Komunën Martanesh (sot Njësia Administrative Martanesh), në përputhje me nenin 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka deklaruar atë “nëpunëse civile”;

19. Me aktin nr. 2618/2 prot., datë 21.07.2017, punonjësja \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialist i Menaxhimit të Pronave në Njësinë Administrative Ostren*” është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, për arsye të ristrukturimit të institucionit (shkurtime të vendit të punës).

Nga analiza e akteve të mësipërme rezulton se në 15 raste, njësia përgjegjëse e Bashkisë Bulqizë ka dalë me vendime për revokimin e akteve të emërimit “*për shkak të moskryerjes së procedurës së konkurrimit të hapur, si e vetmja mënyrë për plotësimin e pozicioneve të punës të kategorisë ekzekutive, përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”. Në kuptim të neneve 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe nenit 108 të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, aktet e emërimit të këtyre punonjësve për shkak të mosrespektimit të procedurës janë akte absolutisht të pavlefshme, sikundër është argumentuar edhe në përmbajtjen e Vendimit paralajmërues nr. 64, datë 30.03.2017, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 17, datë 09.02.2017*”, objekt i këtij verifikimi.

Në vështrim të neneve 110 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, akti absolutisht i pavlefshëm duhet të konstatohet si i tillë dhe të anulohet nga organi publik që e ka nxjerrë atë. Termi “*revokim*” nuk përmendet në asnjë rast gjatë përmbajtjes së këtij ligji. Njësia përgjegjëse duhet të tregojë kujdes që pasaktësi të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen.

Në tre raste rezulton se njësia përgjegjëse ka njoftuar punonjësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”. Duke qenë se marrëdhënia e punësimit në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil rregullohet nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Kryetari i Bashkisë nuk mund të bazohet për përfundimin e kësaj marrëdhënieje në Kodin e Punës, por duhet të vepronte në të njëjtën mënyrë si në 15 rastet e tjera, me ndryshimin e vetëm që në vend të termit revokim duhej të përdorte termin anulim.

Në 7 rastet e tjera, nga ana e Kryetarit të Bashkisë nuk është marrë asnjë masë për anulimin e akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin.

Gjatë procesit të verifikimit, grupi i punës konstatoi se njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Bulqizë me njoftimin nr. 2954 prot., datë 28.07.2017, ka dërguar pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit shpalljet për procedurat e lëvizjes paralele, pranimit në shërbimin civil dhe ngritjes në detyrë për 10 pozicionet e mëposhtme:

- *Drejtor / Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;*



- *Specialist i Kontrollit në Terren;*
- *Specialist Arkiv – Protokolli në Bashkinë Bulqizë;*
- *Specialist Veteriner në Bashkinë Bulqizë;*
- *Specialist Veteriner në Njësinë Administrative Shupenzë;*
- *Specialist Veteriner në Njësinë Administrative Ostren;*
- *Specialist i Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Trebisht;*
- *Specialist i Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Martanesh;*
- *Specialist i Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Shupenzë;*
- *Specialist i Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Trebisht.*

Sikundër është evidentuar edhe në vendimin paralajmërues objekt i këtij verifikimi, 18 pozicionet e tjera janë shpallur më herët nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Bulqizë.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Bulqizë, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” dhe në zbatim të orientimeve në pikën 3 të vendimit të Komisionerit, me Vendimin Nr. 46, datë 06.06.2017, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 28, datë 09.03.2017 ‘Për miratimin e planit vjetor të rekrutimeve për vitin 2017, në pozicionet e administratës, pjesë të shërbimit civil’”, ka pasqyruar në planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil edhe një pjesë të pozicioneve të cilat ishin plotësuar në kundërshtim me ligjin.

Në pikën 4 të vendimit të Komisionerit është kërkuar përmbyllja e procesit të nisur për 18 procedurat e konkurrimit dhe fillimi i procesit për 10 pozicionet e tjera të lira në kuptim të ligjit, duke u kujdesur për përmbushjen e të gjitha rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse dalë në bazë e për zbatim të tij.

Me njoftimet nr. 57 prot., datë 10.01.2017, nr. 1532 prot., datë 24.04.2017 dhe nr. 2954 prot., datë 28.07.2017, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Bulqizë ka dërguar pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit shpalljet për procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil për këto pozicione: **1. Specialist i Menaxhimit të Pronave në Njësinë Administrative Ostren;** **2. Drejtor në Drejtorinë e Taksave dhe Menaxhimit të Pronave;** **3. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Emergjencave Civile;** **4. Specialist i Mbrojtjes; Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Gjoricë;** **5. Specialist i Mbrojtjes; Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Zerqan;** **6. Specialist i Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Ostren;** **7. Specialist i Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Gjoricë;** **8. Specialist i Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë;** **9. Specialist i Ndihmës Ekonomike në Njësinë Administrative Zerqan;** **10. Specialist i Menaxhimit të Pronave në Njësinë Administrative Fushë-Bulqizë;** **11. Drejtor / Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;** **12. Specialist i Kontrollit në Terren;** **13. Specialist Arkiv –**

*Protokolli në Bashkinë Bulqizë; 14. Specialist Veteriner në Bashkinë Bulqizë; 15. Specialist Veteriner në Njësinë Administrative Shupenzë; 16. Specialist Veteriner në Njësinë Administrative Ostren; 17. Specialist i Ndhmës Ekonomike në Njësinë Administrative Trebisht; 18. Specialist i Ndhmës Ekonomike në Njësinë Administrative Martanesh; 19. Specialist i Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Shupenzë; 20. Specialist i Mbrojtjes dhe Administrimit të Tokës në Njësinë Administrative Trebisht; 21. Specialist i barazisë gjinore dhe dhunës në familje.*

Referuar shkresës nr. 1554 prot., datë 25.04.2017, “*Kthim përgjigje*”, të Bashkisë Bulqizë drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe strukturës aktuale të kësaj Bashkie, miratuar me Vendimin Nr. 24, datë 01.03.2017, “*Për miratimin e strukturës / organikës / kategoritë, nivelin e pagave për çdo pozicion të administratës së Bashkisë, ndërmarrjeve dhe njërive shpenzuese në varësi të Bashkisë Bulqizë, për vitin 2017*”, rezulton se, pozicionet “*Specialist i Protokoll Arkivës në Njësitë Administrative Shupenzë, Martanesh, Fushë-Bulqizë, Ostren, Gjoricë, Trebisht*” janë nxjerrë jashtë fushës së administrimit të shërbimit civil, duke ndryshuar edhe emërtesë (“*Punonjës të Arkivës në Njësitë Administrative*”). Pozicioni “*Specialist i Marrëdhënieve me Median*”, me strukturën e re ka pësuar ndryshime. Ai nuk ekziston më si pozicion më vete, por është bashkuar me pozicionin “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”.

Nga këqyrja e akteve të administruara nga grupi i punës, rezulton se me Urdhrin Nr. 236, datë 30.08.2016, është krijuar Komiteti i Përhershëm i Pranimit në Kategorinë Ekzekutive (*i vlefshëm për një periudhë 1-vjeçare, pra deri më datë 30.08.2017, në përfundim të së cilës ka dalë Urdhri Nr. 276, datë 11.09.2017, “Për krijimin e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në kategorinë ekzekutive”*); me Urdhrat Nr. 26 dhe Nr. 26/1, datë 15.02.2017, janë krijuar Komitetet e Pranimit për Ngritjen në Detyrë, sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 242, datë 18.05.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe të Vendimit Nr. 243, datë 18.05.2015, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, të Këshillit të Ministrave.

Me shkresat nr. 57/1 prot., datë 23.01.2017, nr. 281 prot., datë 25.01.2017, nr. 2954/2 prot., datë 11.08.2017 dhe nr. 2954/3 prot., datë 14.08.2017, të Bashkisë Bulqizë është njoftuar Shërbimi Kombëtar i Punësimit se nuk është paraqitur asnjë kandidat për procedurën e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë për 22 pozicione të nivelit ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues. Për këtë arsye, këto pozicione janë të hapura për t’u plotësuar përmes procedurës së ngritjes në detyrë dhe pozicionet e kategorisë ekzekutive nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Me shkresat nr. 382 prot., datë 03.02.2017, nr. 383 prot., datë 03.02.2017 dhe nr. 2954/4 prot., datë 24.08.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Bashkia Bulqizë ka njoftuar rezultatet e verifikimit paraprak për procedurat e ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet e mësipërme.

Më tej, me aktet nr. 795/1 prot., datë 07.03.2017; nr. 712/1 prot., datë 17.03.2017; nr. 1850 prot., datë 16.05.2017; nr. 2438 prot., datë 22.06.2017 dhe nr. 3947 prot., datë 13.10.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Bashkia Bulqizë ka njoftuar listën e kandidatëve fitues (*në përfundim të këtij procesi, njësia e burimeve njerëzore të institucionit ka nxjerrë aktet individuale të emërimit*).

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrës së lënë në Vendimin Nr. 64, datë 30.03.2017, "*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 17, datë 09.02.2017*", të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Bulqizë, pavarësisht parregullsisve të evidentuara në përmbajtjen e këtij materiali të cilat duhet të mbahen parasysh për t'u korrigjuar dhe për të mos u përsëritur më në të ardhmen, janë bërë përpjekje për të zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*" dhe Rregulloren, "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 64, datë 30.03.2017, "*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 17, datë 09.02.2017*", në Bashkinë Bulqizë.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Bulqizë, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 64, datë 30.03.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Bulqizë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**